VENDIM
Nr. 514, datë 19.7.2019

PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "PËR DHOMËN E BIZNESIT TË DIASPORËS – KRIJIMI DHE NXITJA E INVESTIMEVE TË DIASPORËS NË SHQIPËRI", DHE ZBATIMIN E TIJ NGA FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", të neneve 6, pika 4, dhe 7, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 32/2018, "Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin e projektit "Për Dhomën e Biznesit të Diasporës – krijimi dhe nxitja e investimeve të diasporës në Shqipëri", me kohëzgjatje 28 (njëzet e tetë) muaj, me një fond prej 9 000 000 (nëntë milionë) lekësh, sipas projektit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për vitin 2019, me qëllim krijimin dhe organizimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës si mekanizëm për mbrojtjen dhe nxitjen e bizneseve të diasporës shqiptare, Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh, i cili përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
3. Fondet shtesë për projektin bashkëlidhur këtij vendimi do të sigurohen nga donatorë si dhe nga të ardhurat e përfituara nga aktivitetet dhe shërbimet e ofruara nga Dhoma e Biznesit të Diasporës.
4. Projekti "Për Dhomën e Biznesit të Diasporës – krijimi dhe nxitja e investimeve të diasporës në Shqipëri", bashkëlidhur këtij vendimi, do të zbatohet nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.
5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shtetit për Diasporën dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

"PËR DHOMËN E BIZNESIT TË DIASPORËS – KRIJIMI DHE NXITJA E INVESTIMEVE TË DIASPORËS NË SHQIPËRI"
PROJEKTPROPOZIM
KORRIK 2019

Përmbajtja

SEKSIONI I
1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME
SEKSIONI II 2.
BAZAT INSTITUCIONALE DHE MANAXHIMI I PROJEKTEVE
2.1 Përshkrimi i institucionit
2.2 Misioni i FSHZHD dhe mënyra e qeverisjes
2.2.1 Statusi Juridik
2.2.2 Objektivat
2.3 Projekte/ iniciativa të mëparshme te FSHZHD

2.3 Eksperiencat me donatorë
SEKSIONI III
PROJEKT PROPOZIMI
3.1 Titulli i Projektit: ""“Organizimi i Diasporës për Sipërmarrje dhe Mekanizmat Mbështetës”....
3.2 Përmbledhje e projektit
3.3 Përshkrim i Projektit
3.4 Nevojat/problemet që do te adresojë projekti
3.5 Qëllimi dhe Objektivat Specifike të Projektit
3.6 Rezultatet / Ndikimet
3.7 Aktivitetet
3.8 Grupi i Punës në Projekt
3.9 Përfituesit, Partneret dhe Koordinimi
3.10 Monitorimi dhe Vlerësimi
3.11 Vazhdimësia
3.12 Dukshmëria/ Vizibiliteti

SEKSIONI I
1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Organizata zbatuese	**FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS**
Titulli i projektit	“PËR DHOMËN E BIZNESIT TË DIASPORËS – KRIJIMI DHE NXITJA E INVESTIMEVE TË DIASPORËS NË SHQIPËRI”
Vendi i zbatimit	Shqipëri
Fusha tematike	Angazhimi i Bizneseve të Diasporës shqiptare, rrjetëzimi dhe mobilizimi nëpërmjet mekanizmave të rinj për nxitjen e sipërmarrjes dhe promovimi i tyre si faktor ndikues në zhvillimin socio - ekonomik të Shqipërisë.
Kostoja e përgjithshme e projektit (LEK)	9,000,000 (nëntë milionë)
Kohëzgjatja e projektit	28 Muaj
Kontakti	Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës
Adresa e e-mail	info@adfd.al
Nr. i telefonit	+355 4 2277455
Grupet e synuara	Bizneset shqiptare në Diasporë Bizneset në Shqipëri
Përfituesit kryesorë	Sipërmarrës të Diasporës dhe vendas Institucione publike (qendrore dhe vendore) Studentë të universiteteve publike dhe private

SEKSIONI II
2. BAZAT INSTITUCIONALE DHE MANAXHIMI I PROJEKTEVE
2.1 Përshkrimi i institucionit

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është një nga tre strukturat kryesore të Ministrit të shtetit për Diasporën, të cilat do të aplikojnë politikat e reja shtetërore për Diasporën shqiptare. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës (FSHZHD) synon të jetë një institucion që punon me përkushtim e seriozitet për të transformuar politikat për zhvillimin e Diasporës në rezultate konkrete.

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës - zhvillon veprimtarinë e tij në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr.32/2018, "Për Fondin Shqiptar Për Zhvillimin e Diasporës". Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është person publik, jobuxhetor. Veprimtaria e tij ka filluar më 22 tetor 2018. Funksionimi fillestar i Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës u bazua në projektin e miratuar me VKM nr. 611, datë 17.10.2018, "Për financimin e projektit "Diaspora për Zhvillim" dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës".

2.2 Misioni i FSHZHD-së dhe mënyra e qeverisjes

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka për mision sigurimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare, në kuadrin e nxitjes së zhvillimit social-ekonomik e kulturor, bazuar në Strategjinë Kombëtare për Diasporën, nëpërmjet promovimit, inkurajimit dhe nxitjes së prirjeve filantropike dhe investimeve në mbështetje të zhvillimit të Diasporës shqiptare në Republikën e Shqipërisë e jashtë saj.

2.2.1 Statusi juridik

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është person juridik publik. Fondi menaxhon projektet e financuara nga Këshilli i Ministrave ose donatorët, në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në marrëveshje përkatëse.

2.2.2 Objektivat

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës shërben si mekanizëm i njohur nga ligji për nxitjen e prirjeve filantropike/donacioneve dhe investimeve të anëtarëve të Diasporës në përpjekjet për zhvillimin social-ekonomik e kulturor në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka për objekt të veprimtarisë hartimin, menaxhimin, financimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e projekteve të lidhura me misionin e saj.

Në përmbushjen e misionit të tij, Fondi udhëhiqet nga këta objektiva:

- Mbështetjen e anëtarëve të diasporës për të mundësuar kontributin e tyre në çështjet arsimore, kulturore, shëndetësore;
- Forcimin e bashkëpunimit me organizata të tjera jofitimprurëse dhe organizata filantropike, të angazhuara në mënyrë aktive në zhvillimin social-ekonomik e kulturor.

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, synon të bashkëpunojë me komunitete dhe shoqata/organizata shqiptare jashtë vendit që dëshirojnë të kanalizojnë kursimet e tyre drejt investimeve, zhvillimit të mbështetjes së projekteve për investimet e Diasporës, bazuar në përvojat më të mira.

2.3 Projekte/ iniciativa të mëparshme të FSHZHD-së

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës synon të jetë aktiv në marrëdhëniet me institucionet dhe partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë duke formalizuar nëpërmjet memorandumeve të mirëkuptimit dhe marrëveshjeve shkëmbimin e informacionit, ekspertizës dhe bashkëpunimin në fushën e Diasporës dhe migracionit dhe veçanërisht atë të biznesit. Gjatë vitit 2018, Fondi është angazhuar për të qenë pjesë e disa marrëveshjeve dhe memorandumeve të mirëkuptimit, të cilat janë ende në proces negocimi midis palëve, specifikat e të cilave shpjegohen si më poshtë vijon.

- *Memorandum Mirëkuptimi midis FSHZHD-së dhe Unionit të Dhomave të Biznesit në Greqi* për bashkëpunim në fushën e sipërmarrjes dhe tregtisë;
- Marrëveshje Bashkëpunimi midis FSHZHD-së dhe Konfederatës Kombëtare të Zejtarisë dhe Sipërmarrjes së Vogël dhe të Mesme në Itali, për krijimin e Dhomës së Tregtisë për Diasporën shqiptare në Itali;
- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe informimin e diasporës', neni 2 pika 2: Palët do të nxisin dhe ndihmojnë krijimin e Dhomës (Odës) së biznesit të Diasporës në Tiranë dhe Prishtinë duke respektuar rregullat e funksionimit të të njëjtit rrjet biznesi në diasporë.
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Fondacionin Magnia Grecia, Itali. Kjo marrëveshje parashikon bashkëpunimin shkencor dhe në fushën e kulturës në bazë të të cilit do të krijohet një partneritet, një Observator që do të monitorojë komunitetin shqiptar në Itali dhe

do të ofrojë informacion të dobishëm për proceset vendimmarrëse të Fondit Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës, si dhe do të promovojnë krijimin e një rrjeti për zbatimin e programeve dhe projekteve.

Një nga prioritetet e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në punën e tij për vitin 2019 është asistimi në krijimin e Dhomës së Biznesit për Diasporën, mbështetur në ligjin nr. 32/2018, "Për Fondin Shqiptar Për Zhvillimin e Diasporës". FSHZHD-ja do të asistojë duke ofruar orientimet e duhura lidhur me asistencën teknike dhe ligjore, shkëmbimin e informacionit, duke kontribuar në krijimin e një institucioni shumë të rëndësishëm që do të shërbejë si pikë orientimi për të gjithë shqiptarët e Diasporës që dëshirojnë të investojnë në Shqipëri.

Për më tepër, FSHZHD-ja gjatë vitit 2019 do të zbatojë aktivitetin nr. 4 "Si të fillosh një biznes në Shqipëri" në kuadër të projektit Diaspora për Zhvillim.

Aktiviteti "Si të fillosh biznes në Shqipëri" do të mundësojë:

- Identifikimin e aktorëve kyç për studimin e situatës dhe tregut shqiptar duke ngritur një grup ekspertize (ekspertë lokal dhe ndërkombëtarë).
- Krijimin e një moduli informativ i cili do të ofrojë shërbime për anëtarët e Diasporës në lidhje me mundësitë për investime në vendin e origjinës dhe aktet filantropike.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit "Diaspora për Zhvillim" në 6-mujorin e parë të vitit 2019 janë kryer një sërë eventesh dhe aktivitetesh për krijimin dhe hartëzimin e rrjetit.

Projeksioni i aktiviteteve gjatë vitit 2019 i FSHZHD-së është në proces edhe si rezultat i maturimit në proces i një institucioni, i cili përbën një eksperiencë të re administrative dhe po ashtu nga koha e shkurtër e fillimit të punës.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit "Diaspora për Zhvillim" në 6-mujorin e parë të vitit 2019 janë kryer një sërë eventesh dhe aktivitetesh ndër të cilat takimet në Diasporë për ngritjen e vetëdijes dhe hartëzimin e krijimin e rrjetit:

15 shkurt 2019 – takim me rrjetin e avokatëve në Institutin Enciklopedik Treccani në Romë, Itali.

Në takimin e kryer në ambientet e Institutit Enciklopedik Italian "Treccani" u diskutua mbi situatën e profesionistëve shqiptarë në Itali dhe rrjetëzimin e tyre në funksion të mbrojtjes së interesave të komunitetit shqiptar në Itali.

Në kuadër të këtij aktiviteti, është në proces edhe nënshkrimi i një marrëveshje me Institutin Enciklopedik Italian Treccani për bashkëpunim në fushën e Diasporës: projekte në fushën arsimore dhe kulturore si dhe kërkime e studime shkencore në fushën e emigracionit.

15 shkurt 2019 – Vizitë pune me përfaqësues të Konfederatës Kombëtare të Zejtarisë (KKZ), Rome, Itali.

Gjatë vizitës u diskutua mbi koordinimin dhe bashkëpunimin në fushën e sipërmarrjes dhe tregtisë, si një mjet i rëndësishëm për të nxitur investimet dhe për të forcuar marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Italisë. Gjithashtu gjatë këtij takimi u diskutuan detajet konkrete për krijimin e Dhomës së Tregtisë për Diasporën shqiptare në Itali, e cila në bashkëpunim me Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës do të jetë një pikë mbështetëse për biznesin e vogël dhe të mesëm të krijuar nga shqiptarët e vendosur në Itali.

16 shkurt 2019 – Pjesëmarrje në konferencën "Diaspora shqiptare, pikënisje për formimin dhe zhvillimin e Europës", Romë, Itali.

Organizuar nga "Integra Onlus" në Itali dhe fondacioni "Ura për të ardhmen", gjatë këtij takimi u diskutua për një bashkëpunim strategjik mbi tema thelbësore të politikave migruese, duke u përqendruar në veçanti tek roli që Diaspora ka si ure mes vendeve dhe kulturave të ndryshme. Ky ishte diskutimi i parë i një cikli të plotë seminaresh të cilët do të mbahen në të ardhmen, me fokus Diasporën.

4–8 shkurt 2019 – Study Visit, në bashkëpunim me IOM, Romë, Itali

FSHZHD ishte pjesëmarrëse e vizitës studimore si pjesë e programit 'Angazhimi i Diasporës shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë' – financuar nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS) nën angazhimin politik të Ministrisë për Punët e Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Italisë (MAECI) – Organizata Ndërkombëtare për

Migracionin (IOM) koordinoi një seri takimesh dhe konsultimesh teknike ndërmjet një delegacioni me përfaqësues të institucioneve shqiptare të përfshirë në angazhimin e diasporës, me homologë dhe me entitete që punojnë për angazhimin e diasporës në Itali.

28 shkurt–2 mars 2019 - Samiti II i Diasporës, Tiranë, Shqipëri

Samiti i Dytë i Diasporës ishte aktiviteti më i rëndësishëm i 2019 për të gjitha institucionet që operojnë në fushën e diasporës dhe veçanërisht për FSHZHD-në. Në Samitin II të Diasporës pati pjesëmarrës nga e gjithë hapësira shqiptare dhe personalitete të shquara brenda dhe jashtë vendit. Ky event dhe diskutimet e realizuara përgjatë tij do të jenë pikënisja për hartimin e politikave të reja të Shtetit Shqiptar në fushën e diasporës, shërbejnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në njohjen e nevojave të Diasporës shqiptare nëpër botë si dhe në forcimin e lidhjeve me Shqipërinë dhe në rritjen e interesit dhe ndikimit të diasporës në zhvillimin e vendit. Në këtë event, FSHZHD-ja u prezantua me stendën e vet dhe në organizimin e paneleve lidhur me ekonominë, sipërmarrjen, arsimin, kulturën, artin dhe filantropinë si cilësi komunitare etj.

16 mars 2019 – pjesëmarrje në Konferencën III Gruas me temë "Roli i Gruas në Diasporë, kthimi në atdhe, sfidat dhe perspektivat", Korçë, Shqipëri.

Gra nga qytete të ndryshme të Greqisë, si: Athina, Selaniku, Patra, Veria, por edhe nga qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe jo vetëm, si edhe anëtare të organizatave simotra, u mblodhën në qytetin e Korçës. Në konferencë u diskutua rreth gruas emigrante, rolit të saj në shoqëri, perspektivës për t'u rikthyer në atdhe si dhe u shkëmbyen eksperienca me gratë që jetojnë në Shqipëri. Eventi u organizua nga Organizata "Jeta" me seli në Athinë të Greqisë dhe degë në disa qytete të shtetit helen.

8–13 prill 2019, SHBA – Boston, Washington

Pjesëmarrje në 11-th Annual Global Empowerment Meeting (GEM19) në Universitetin e Harvardit në datat 8–10 prill 2019, si dhe vizita zyrtare në takime me organizata edhe institucione të ndryshme në Washington DC.

- Takim me përfaqësuesit e Departamentit Amerikan të Shtetit për Punët e Jashtme, zyrën e Edukimit, Diplomacisë Elektronike, Këshilltarin për Rininë Globale, si dhe Zyrtarin e Shtetit, përgjegjës për Shqipërinë. Në këtë takim u diskutua për mënyrën e lehtësimit të pajisjes me viza të shqiptarëve si dhe për programet e shkëmbimit mes universiteteve shqiptare dhe atyre amerikane.

- Takim me drejtorin ekzekutiv të Bordit të Grupit të Bankës Botërore në Washington DC i cili përfaqëson Italinë, Shqipërinë, Greqinë dhe disa vende të tjera. Në këtë takim u diskutua mundësia e thellimit të mbështetjes me projekte të Diasporës shqiptare, si një bashkëpunim midis Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë në kuadrin e Strategjisë së Bankës Botërore për vendin. Synimi i këtij projekti do të ishte kanalizimi i remitancave në një mënyrë të qëndrueshme për zhvillimin e vendit. U diskutua edhe mundësia e organizimit të një takimi vjetor rajonal për remitancat. Gjatë takimit, përfaqësuesit e Bankës Botërore u njohën me politikat shtetërore shqiptare për Diasporën si dhe ecurinë e Strategjisë Kombëtare të Diasporës.

- Takim me shefin e misionit të FMN-së për Shqipërinë. Gjatë këtij bashkëbisedimi, u fol për rëndësinë që ka ky institucion për qeverinë shqiptare. Me interes gjatë kësaj bisede ishte fusha e arsimit dhe lehtësimi i procedurave për rikthimin e shqiptarëve në atdhe.

- Takim i organizuar nga "Open Gov Hub" dhe "Open Goverment Partnership" me temë diskutimi qeverisjen transparente. U paraqitën reformat konkrete që janë aplikuar në politikat shtetërore shqiptare për Diasporën. Gjithashtu u njohën të pranishmit me të gjitha format e publikimit dhe nivelin e transparencës të institucioneve në varësi të tij: Buletini tre mujor i cili paraqet ecurinë e zbatimit të Planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës, "Periodiku" i Fondit të Zhvillimit të Diasporës, Raportet vjetore të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës si dhe publikimin informativ të përjavshëm" Newsletter e Diasporës". Gjatë këtij takimi, OGH – Open Gov Hub prezantoi nismën e saj në Shqipëri, hapjen e zyrës rajonale në Tiranë. Gjatë këtij takimi u fol edhe për

iniciativën për të krijuar Dhomën Tregtare në Pennsylvania, Albanian Chamber in PA, me asistimin edhe të FSHZHD-së.

25–26 prill, Prishtinë–Kosovë.

Në kuadër të projektit Diaspora për Zhvillim që FSHZHD ka në zbatim dhe veçanërisht aktivitetit "për krijimin e rrjetit të profesionistëve në Diasporë", është zhvilluar një vizite pune për njohje dhe shkëmbim përvoje me institucionet në Kosovë.

Objektivi i vizitës ishte takimi me aktorët kyç në Kosovë (institucione shtetërore dhe organizata jofitimprurëse) për të përfituar nga eksperienca dypalëshe në identifikimin e praktikave më të mira për arritjen e objektivave të projektit dhe nxitjen e angazhimit të Diasporës në përgjithësi. Kjo vizitë është realizuar edhe në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës për bashkëpunim në fushën e Diasporës.

Takimet u zhvilluan me institucionet e mëposhtme:

Organizata Germin – Njohja me punën e organizatës Germin për ngritjen e rrjetit të profesionistëve, edhe në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit;

Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike – takim me zv.ministrin dhe drejtuesit e departamenteve lidhur me shkëmbimin e përvojave të dy institucioneve që lidhen me Diasporën, dhe projekteve në zbatim nga institucionet në mbështetje të Diasporës;

Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane – takim në kuadër të ngritjes së Dhomës së Biznesit të Diasporës në Shqipëri dhe diskutim rreth modelit që po implementohet në Kosovë;

Kosovo Ideas - Shkëmbim përvoje dhe idesh në lidhje me ngritjen e mekanizmave *fundraising* për projekte komunitare në Shqipëri;

Asociacioni i Komunave të Kosovës – mekanizëm për të ofruar shërbime dedikuar Diasporës në nivel lokal;

Innovation Center Kosovo – Best practice i nxitjes së start-upeve të Diasporës.

Në këto takime u prezantuan programet, të cilat janë duke u zbatuar dhe projektet e reja në funksion të krijimit të instrumenteve dhe forcimit të komunikimit midis Diasporës dhe institucioneve publike në Kosovë dhe Shqipëri.

17–19 maj 2019 – takim me rrjetin e grave në Selanik në kuadër të Festivalit të Shumëgjuhësisë, Selanik, Greqi.

Në datat 17–19 maj 2019, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës mori pjesë në Festivalin e Shumëgjuhësisë në Selanik, Greqi. Në këtë aktivitet morën pjesë edhe shoqata shqiptare për ruajtjen dhe promovimin e gjuhës shqipe.

Në kuadër të këtij Festivali, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës realizoi një takim me rrjetin e grave në Greqi. Ky takim kishte si synim njohjen me rrjetin e grave, veprimtarinë e tyre, si dhe çështje të tjera me qëllim mbështetjen e iniciativave të tyre në Greqi, forcimin e lidhjeve me vendin e origjinës dhe angazhimin e këtij rrjeti në projektet e ndryshme dedikuar Diasporës shqiptare.

24–25 maj 2019 – pjesëmarrje në Konferencën Ekonomike të Diasporës Shqiptare nga Evropa - B2B, Prishtinë, Kosovë

FSHZHD-ja u bë pjesë e "Konferencës Ekonomike të Diasporës Shqiptare" ku morën pjesë rreth 400 sipërmarrës shqiptarë. Qëllimi i kësaj konference ishte njohja me bizneset shqiptare në Diasporë dhe krijimi i bashkëpunimeve me bizneset vendase për mundësi investimi në Shqipëri dhe Kosovë. Konferenca, ndër të tjera, përmbante takime B2B, panele ekonomike, vizita në komuna dhe në ndërmarrje të suksesshme në Kosovë.

Gjatë kësaj vizite, u realizua edhe një takim me rektorin e Universitetit për Biznes dhe Teknologji në Kosovë (UBT), me synim mundësimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi midis FSHZHD-së dhe UBT-së për çështje në fushën e kërkimit, mësimdhënies, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit.

2.3 Eksperiencat me donatorë

- **IOM** – në kuadër të projektit "Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillim Social dhe Ekonomik";

- **GIZ** – në kuadër të projektit "Migracioni për zhvillim" GIZ kontribuon përmes angazhimit të ekspertëve të diasporës nëpër institucione të ndryshme shqiptare;

- **Banka Botërore** – në kudër të Projektit GreenBack, ministri i Shtetit për Diasporën dhe Fondi i Zhvillimit të Diasporës janë pjesë e grupit këshillimor ndërinstitucional të këtij Projekti, i cili synon kanalizimin në rrugë eficiente të remitancave në ekonominë e vendit.

SEKSIONI III
PROJEKTPROPOZIMI

3.1 Titulli i projektit: "Për dhomën e Biznesit të Diasporës – krijimi dhe nxitja e investimeve të Diasporës në Shqipëri"

3.2 Përmbledhje e projektit

Objektivi i përgjithshëm	*Asistim dhe mbështetje në ngritjen dhe instalimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës si mekanizëm për angazhimin e Diasporës në nxitjen e investimeve dhe sipërmarrjeve, lehtësimin e tregtisë dhe përmirësimin e profilit të investimeve në Shqipëri.*
Objektivat specifikë	➢ Organizimi dhe rrjetëzimi i bizneseve të Diasporës. ➢ Nxitja dhe inkurajimi i sipërmarrjeve nga bizneset shqiptare të Diasporës në Shqipëri për të krijuar vende të reja pune dhe për të rritur zhvillimin ekonomik. ➢ Advokim për përmirësimin e politikave në kuadër të lehtësimit të tregtisë dhe investimeve të diasporës në Shqipëri.
Rezultatet e pritshme	R1 ➢ Asistim dhe mbështetje në ngritjen e Dhomës së Biznesit të Diasporës. ➢ Krijimi i regjistrit të bizneseve të Diasporës. R2 ➢ Përmirësimi i rrjetëzimit midis bizneseve të Diasporës dhe atyre vendase. ➢ Mentorimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri nga bizneset shqiptare të Diasporës. ➢ Kanalizimi i kapitalit për investime të Diasporës në nivel lokal. R3 ➢ Konsulencë financiare dhe ligjore për zhvillimin e biznesit në Shqipëri për sipërmarrësit dhe start-up të Diasporës. R4 ➢ Promovimi i programeve të shkëmbimeve studentore për zhvillimin e kapitalit njerëzor në sektorët kyç të ekonomisë. R5 ➢ Krijimi i urave të komunikimit midis punëdhënësve dhe punëkërkuesve për nxitjen e punësimit.
Aktivitetet kryesore	A1 ➢ Mbështetja në ngritjen e Dhomës së Biznesit të Diasporës. A2 ➢ Forumi i Sektorit privat: "Fuqia e Diasporës, lidhja e komuniteteve dhe bizneseve për zhvillim. Përparësitë e të bërit biznes në Shqipëri". A3 ➢ Ekspertizë rreth infrastrukturës e të bërit biznes dhe hapjen e start-up-eve nga Diaspora në Shqipëri. A4 ➢ Tryezë e rrumbullakët me universitetet publike dhe private për përfshirjen e kapaciteteve studentore në kërkesat për punësim të

	bizneseve të Diasporës dhe vendase. A5 ➢ Dita e karrierës – Diaspora për punësim.
Grupet e synuara	Bizneset shqiptare në Diasporë Bizneset në Shqipëri
Përfituesit kryesorë	Sipërmarrës të Diasporës dhe vendas Institucione publike (qendrore dhe vendore) Studentë të universiteteve publike dhe private

3.3 Përshkrim i projektit

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është: *Asistim dhe mbështetje në ngritjen dhe instalimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës si mekanizëm për angazhimin e Diasporës në nxitjen e sipërmarrjeve, lehtësimin e tregtisë dhe përmirësimin e profilit të investimeve në Shqipëri.* Diaspora shqiptare është një komunitet me biznesmenë të suksesshëm që Dhoma e Biznesit të Diasporës ka për qëllim të përfshijë në sipërmarrje të drejtpërdrejta dhe indirekte në Shqipëri.

Kontributi i Diasporës vlerësuar nga studiues të huaj konsiston në pikat pozitive të mëposhtme:

1. Sjell me vete aftësi të reja (kapital njerëzor) të fituara nëpërmjet përvojës, trajnimit ose edukimit në vendet pritëse.

2. Diaspora luan një rol jetësor në promovimin e investimeve dhe tregtisë duke nxitur tregtinë dypalëshe midis vendeve të origjinës dhe atyre pritëse. Ata mund të përfshihen drejtpërsëdrejti në tregti ose mund të lehtësojnë tregtimin për të tjerët.

3. Vepron si krijues i ndryshimeve sociale në vendin e origjinës, dhe mund të ushtroj një ndikim pozitiv duke ndryshuar marrëdhëniet ekzistuese brenda shoqërisë së origjinës.

4. Kontribuojnë përmes kapitalit social (rrjeteve) që ata kanë fituar si rezultat i përvojës së tyre të migrimit duke shfrytëzuar lidhjet e tyre transnacionale për të lehtësuar partneritetet inovative të biznesit dhe sipërmarrjeve midis vendeve pritëse dhe vendit të origjinës. [1]

Duke marrë në konsideratë elementet e mësipërme edhe për potencialin global të kapitalit financiar, njerëzor dhe social të shqiptarëve në Diasporë, projekti i krijimit të Dhomës të Biznesit për Diasporën në nxitjen e sipërmarrjeve dhe investimeve, duke krijuar lidhje mes bizneseve të Diasporës dhe atyre vendase, vjen si një domosdoshmëri për përfshirjen e strukturuar të saj. Ky projekt-propozim ka si objektiv kryesor të plotësojë kërkesën e munguar të tregut për ekzistencën e Dhomës së Biznesit dhe regjistrit të bizneseve të Diasporës. Kjo do të mundësojë njohjen dhe përmirësimin e indikatorëve të identifikuar si kufizues në përfshirjen aktive të bizneseve të diasporës si dhe marrjen e vendimeve më të mira e të bazuara në evidencë nga agjentët ekonomikë që operojnë në këtë treg. Ngritja e këtij mekanizmi do të shërbejë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik nga sinergjia e bashkëpunimit të bizneseve të Diasporës, veçanërisht në sektorët, në të cilët, Shqipëria gëzon avantazh konkurrues siç janë: sektori i Turizmit, Bujqësia, sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Energjia etj.

Indikatorët e favorshëm si burimet njerëzore dhe ato natyrore, kostot e resurseve dhe ato operative relativisht të ulëta të bizneseve, ofrojnë mundësi të përshtatshme për investime në Shqipëri.

Në këtë funksion Dhoma e Biznesit të Diasporës do të shërbejë si mekanizëm kryesor në krijimin dhe forcimin e rrjetit të bizneseve të Diasporës me ato vendase duke:

- asistuar dhe mbështetur bizneset në Diasporë që synojnë të shtrihen në Shqipëri;

[1] Plaza, S. (2013), "Diaspora Resources and Policies", in the International Handbook on the Economics of Migration, Constant, A.F. and Zimmermann, K.F. editors. Edward Elgar Publishing: Cheltenham, UK, 2013, Chapter 27, pp. 505–529

- ndikuar në lehtësimin e tregtisë;
- ndihmuar bizneset vendase të penetrojnë në tregjet ndërkombëtare;
- rritur mundësitë e tyre për eksport;
- ndihmuar bizneset e Diasporës të identifikojnë sektorët me interes brenda vendit dhe iniciativat sipërmarrëse;
- ndikuar në rritjen e interesimit të investitorëve nga diaspora;
- krijimin e rrjeteve funksionale të bizneseve të Diasporës;
- dhënë kontributin në politikat zhvillimore dhe planet strategjike për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

Strategjia kombëtare për Diasporën, në masën 33, në kuadër të krijimit të Dhomës së Biznesit, parashikon krijimin e një forumi të pavarur të ekspertëve nga Diaspora dhe Shqipëria, për të nxitur dhe orientuar sipërmarrjet dhe kapitalin investues të Diasporës në ekonominë e vendit. Kjo strategji parashikon rritjen e kapaciteteve profesionale për dhënien e shërbimeve mbështetëse lidhur me mundësitë e investimeve në Shqipëri (klimën e biznesit, zhvillimin ligjor etj.), duke shërbyer si ndërlidhje e sipërmarrësve nga Diaspora me komunitetin e biznesit në vendin e origjinës.

Mundësia e implementimit të një mekanizmi të tillë si Dhoma e Biznesit të Diasporës do të profilizojë interesat dhe do të krijojë mekanizma bashkëpunimi në fushën e sipërmarrjes, tregtisë dhe investimeve.

Dhoma e Biznesit të Diasporës në Shqipëri do të mbulojë fillimisht rrjetet e diasporës të biznesit në vendet fqinje si Itali, Greqi dhe në vendet e tjera ku ka një përqendrim të numrit të bizneseve që drejtohen nga Diaspora shqiptare, si p.sh.: Gjermani, Angli, Zvicër, Francë, USA, Kanada etj.

3.4 Nevojat/problemet që do të adresojë projekti

Pas viteve 1990 numri i emigranteve shqiptare është afro 30 % e numrit të popullsisë në bazë të dhënave të INSTAT-it edhe EUROSTAT-it. Gjatë këtyre 30 viteve ata kanë krijuar kapacitete njerëzore dhe financiare, duke zhvilluar biznese të llojeve të ndryshme në vendet ku janë. Sipas Bashkimit të Dhomave të Tregtisë së Italisë dhe të Movimrepse numërohen 30,021 sipërmarrje të themeluara nga emigrantët shqiptar në të gjithë Italinë. Sipas të dhënave të publikuara, sektori që ka numrin më të lartë të bizneseve të themeluara nga shqiptarët është ai i ndërtimit. Bizneset në sektorin e ndërtimeve zënë thuajse 72 për qind të totalit të gjithë aktiviteteve të shqiptarëve në Itali. Në sektorin e tregtisë me pakicë dhe shumicë, si dhe në sektorin e shërbimeve operojnë përkatësisht rreth 16 për qind e sipërmarrjeve të themeluara nga shqiptarët. Pesha e sipërmarrjeve është më e ulët në sektorët prodhues, agropërpunues dhe transport, ku sipërmarrjet shqiptare përllogariten të jenë rreth 2000. Për sa i përket qyteteve italiane ku sipërmarrësit shqiptarë kanë marrë më së shumti iniciativë të ngrenë bizneset e tyre janë: Firence me 1,702 biznese, Milano me 1,608 biznese, Genova me 1,356 biznese, Torino, me 1031 biznese, Savona me 998, Roma me 917 biznese, Peruxhia me 702. Qytetet në jug të Italisë kanë një numër më të vogël të bizneseve me themelues shqiptarë.

Emigrantët shqiptarë në Greqi janë punësuar në masë 80–90% në sektorin e ndërtimit, bujqësisë ose shërbimeve. 5-7% të emigrantëve shqiptarë në Greqi ka arritur të themelojë biznesin e tyre. Sipas Dhomës të Tregtisë dhe Industrisë të Athinës në Greqi janë të regjistruar rreth 20000 emigrantë shqiptarë që kanë biznesin e tyre. Nga këto 39,3% operojnë në sektorin e tregtisë me pakicë, 34,4% e bizneseve të emigrantëve shqiptarë në Greqi operojnë me tregtinë më shumicë kurse 19,8% e sipërmarrësve shqiptarë në Greqi veprojnë në sektorin e ndërtimit ose shërbimeve. Për sa i përket qyteteve greke ku sipërmarrësit shqiptarë kanë marrë më së shumti iniciativë të ngrenë bizneset e tyre janë Athina, dhe një pjesë e konsiderueshme në Selanik.

Më 2014-n, u krijua Unioni Global i bizneseve shqiptare në Diasporë, në të cilin bëjnë pjesë 17 kryetaret e rrjeteve të unioneve shqiptare në botë si sipërmarrës shqiptare të suksesshëm me veprimtarinë e tyre në Diasporë. Rrjetet e Unionit të Biznesit janë në 17 shtete të ndryshme të botës. Katër rrjete janë në Amerikë, një në Kanada dhe të tjerat në shtetet të Evropës. Rrjetet e

diasporës mund të luajnë një rol kyç në organizimin e grupeve të ndryshme të interesit dhe ndërmarrjeve, si dhe në rivitalizimin e lidhjes së tyre me vendin e origjinës.

Në kushtet kur mungon një strukturë koordinuese edhe informuese për të përfshirë Diasporën e Biznesit në Shqipëri, dhoma e Biznesit në Shqipëri do të adresojë plotësimin e nevojave të grupeve të interesit të biznesit për të kontribuar në Shqipëri. Problematikat me të cilët ndeshet biznesi i Diasporës shqiptare në vendin e origjinës janë të lidhura me:

- mungesën e kontakteve me institucionet përgjegjëse;
- mungesën e informacionit për infrastrukturën e të bërit biznes në Shqipëri;
- identifikimin e prioriteteve për investime.

3.5 Qëllimi dhe objektivat specifikë të projektit

Objektivi i përgjithshëm i projektit është: *Asistim dhe mbështetje në ngritjen dhe instalimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës si mekanizëm për angazhimin e Diasporës në nxitjen e sipërmarrjeve, lehtësimin e tregtisë dhe përmirësimin e profilit të investimeve në Shqipëri.*

Objektivat specifikë:

- Organizimi dhe rrjetëzimi i bizneseve të Diasporës;
- Nxitja dhe inkurajimi i sipërmarrjeve nga bizneset shqiptare të Diasporës në Shqipëri për të krijuar vende të reja pune dhe për të rritur zhvillimin ekonomik;
- Advokim për përmirësimin e politikave në kuadër të lehtësimit të tregtisë dhe investimeve të diasporës në Shqipëri.

Qëllimi në mbështetjen për ngritje të Dhomës së Biznesit është bashkëpunimi midis bizneseve të Diasporës dhe atyre vendase në sipërmarrje, zhvillimin e tregtisë mes bizneseve, gjetjen e tregjeve të reja dhe rritjen e mundësive për eksport. Përmirësimi i indikatorëve të identifikuar si kufizues në përfshirjen aktive të bizneseve të diasporës janë:

- mungesa e një regjistri të mirëfilltë me bizneset e Diasporës;
- mungesa e një sporteli (me një ndalesë – One Stop Shop) të posaçëm për dhënien e gjithë informacionit të nevojshëm në shërbim të bizneseve të Diasporës;
- mungesa e një zyre të posaçme për të suportuar Start up-et e Diasporës;

3.6 Rezultatet / ndikimet

Rezultatet kryesore të projektit përfshijnë:

Rezultati 1

- Asistim dhe mbështetje në ngritjen e Dhomës së Biznesit të Diasporës
- Krijimi i regjistrit të bizneseve të Diasporës

Rezultati 2

- Përmirësimi i rrjetëzimit midis bizneseve të Diasporës dhe atyre vendase.
- Mentorimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri nga bizneset shqiptare të Diasporës.
- Kanalizimi i kapitalit për investime të Diasporës në nivel lokal

Rezultati 3

-Konsulencë financiare dhe ligjore për zhvillimin e biznesit në Shqipëri për sipërmarrësit dhe start-up të Diasporës.

Rezultati 4

- Promovimi i programeve të shkëmbimeve studentore për zhvillimin e kapitalit njerëzor në sektorët kyç të ekonomisë.

Rezultati 5

- Krijimi i urave të komunikimit midis punëdhënësve dhe punëkërkuesve për nxitjen e punësimit.

3.7 Aktivitetet

Aktivitetet që kontribuojnë në arritjen e rezultateve të mësipërme:

Aktiviteti 1. Mbështetja në ngritjen e Dhomës së Biznesit të Diasporës

Ngritja e mekanizmit për angazhimin e Diasporës në nxitjen e sipërmarrjes dhe afrimin e bizneseve të Diasporës me ato vendase, lehtësimin e tregtisë mes tyre dhe përmirësimin e klimës në të bërit biznes dhe të investimeve.

1.1 Ngritja e grupit të ekspertizës për themelimin dhe mbarëvajtjen e Dhomës së Biznesit të Diasporës;

1.2 Mbështetje në hartimin dhe formimin e statutit të Dhomës së Biznesit të Diasporës;

1.3 Lançimi dhe inaugurimi i Dhomës së Biznesit të Diasporës

Aktiviteti 2. Forumi i Sektorit privat: "Fuqia e Diasporës, lidhja e komuniteteve dhe bizneseve për zhvillim. Përparësitë e të bërit biznes në Shqipëri".

Për të realizuar gjithëpërfshirjen e territorit të Shqipërisë do të realizohen tre forume tre ditore.

Forumi 1: Shqipëria qendrore

Forumi 2: Shqipëria jugore

Forumi 3: Shqipëria veriore

2.1 Faza përgatitore për zhvillimin e forumeve

2.2 Panele diskutimi ndërmjet vendimmarrësve, ekspertëve dhe përfaqësuesve të rrjeteve të bizneseve nga diaspora dhe atyre vendorë.

2.3 Prezantimi i regjistrit të bizneseve të Diasporës dhe vënia e tij në dispozicion për bizneset pjesëmarrëse.

2.4 Takime të formatit B2B mes bizneseve lokale dhe atyre nga diaspora, si hapësirë për rrjetëzim dhe lidhje mes bizneseve, institucioneve dhe organizatave

Aktiviteti 3. Ekspertizë rreth infrastrukturës e të bërit biznes dhe hapjen e start-up-eve nga Diaspora në Shqipëri

3.1 Realizimi i fishave në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dedikuar çështjeve të tregtisë dhe investimeve për të interesuarit nga diaspora për legjislacionin shqiptar.

3.2 Asistencë në identifikimin e nevojave/ ofertave për fushat me interes për bizneset e Diasporës.

3.3 Monitorim për avancimin e themelimit të bizneseve të Diasporës në Shqipëri.

Aktiviteti 4. Tryezë e rrumbullakët me Universitetet publike dhe private për përfshirjen studentore në kërkesat e punësimit nga bizneset e Diasporës dhe ato vendase.

4.1 Sesion informues për angazhimin aktiv të zyrave të karrierës pranë universiteteve në kanalizimin e kapaciteteve studentore drejt bizneseve të diasporës dhe atyre vendase.

Aktiviteti 5. Dita e karrierës – Diaspora për punësim.

Panair pune me biznese nga Diaspora, i cili shërben si pikë takimi mes punëdhënësve dhe punëmarrësve. Ky aktivitet do të zhvillohet në bashkëpunim me zyrat e karrierës në universitetet shqiptare publike dhe private të cilat do të sigurojnë pjesëmarrjen e studenteve në panair sipas specifikave të bizneseve dhe tregut të punës.

5.1 Faza përgatitore për zhvillimin e panairit

5.2 Dita e karrierës. Intervista ad – hoc.

3.8 Grupi i punës në projekt

Projekti do të menaxhohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës në bashkëpunim me target grupet e projektit dhe institucionet e tjera relevante në projekt.

3.9 Përfituesit, partneret dhe koordinimi

Në këtë projekt përfituesit edhe partneret do të jenë:

- sipërmarrës të Diasporës dhe sipërmarrës vendas apo në rajon;
- institucione publike (qendrore dhe vendore);
- studentë të universiteteve publike dhe private.

Bazuar edhe në marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Bashkëpunim, nxitjen e biznesit dhe informimin e Diasporës, ngritja e Dhomës së Biznesit të Diasporës në Tiranë do të jetë një instrument mjaft i rëndësishëm edhe për nxitjen e Dhomës (Odës) së Biznesit të Diasporës në Prishtinë.

3.10 Monitorimi dhe vlerësimi

Projekti do të monitorohet edhe vlerësohet duke përdorur vlerësuesit sasiore edhe cilësorë ku përfshihen:

- numri i bizneseve shqiptare që do të shfaqin interes për të kontribuar në Shqipëri;
- aktivitete informuese të organizuara nga Dhoma e Biznesit për Diasporën në Shqipëri;
- materialet informuese mbi kuadrin ligjor, tregtar, financiar në Shqipëri;
- promovimi dhe vizibiliteti i dhomës se biznesit për diasporën në Shqipëri përmes faqes *web* dhe rrjeteve sociale.

3.11 Vazhdimësia

Pas afatit 3-vjeçar, vazhdimësia e projektit synon të realizohet përmes kuotave të anëtarësimit të bizneseve shqiptare të Diasporës në Dhomën e Biznesit për diasporën në Shqipëri, si dhe përthithjen e fondeve nga donatorë të tjerë brenda edhe jashtë vendit.

3.12 Dukshmëria/ vizibiliteti

- Publikim në portalin e dedikuar Dhomës së Biznesit të Diasporës
- Publikim në mediat kombëtare dhe lokale mbi zhvillimin e aktiviteteve kryesore të projektit;
- Krijimi i materialeve vizuale (video dhe albume fotografike) gjatë aktiviteteve, të cilat do të shërbejnë si materiale promovuese për projektin.
- Përdorimi i rrjeteve sociale në faqet e MSHD, AKD, FSHZHD, QBD të internetit dhe faqet e mediave sociale (*Facebook, Twitter, You Tube*) për promovimin e aktiviteteve kryesore.

3.13 Buxheti

Buxheti bashkëlidhur në format *Excel.*


Buxheti Final per VKM te dhomes se biznesit_15072019perfundimtare [Read-Only] - Microsoft Excel
"PËR DHOMËN E BIZNESIT TË DIASPORËS - KRIJIMI DHE NXITJA E INVESTIMEVE TË DIASPORËS NË SHQIPËRI"
2019
2020
2021
Sheet1
Ready
12:21 PM